



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 34/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Agon Ramadani- Kryetar, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Vjosa Gradinaj- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Muhamet Muçiqi BI NNP Ndertimtari", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave ne Komunen e Prishtines" me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 03.05.2023, morri:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar, ankesa e datës 12.01.2023, e OE "Muhamet Muçiqi BI NNP Ndertimtari", (Nr.34/23), e parashtruar kundër Vendimit të AK për anulim të procedurës, të datës 28.12.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave ne Komunen e Prishtines" me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK Anullohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmar masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtrroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31, par 6 të Rregullores për Punën e Bordit të OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.01.2023, OSHP (në sistemin elektronik) ka pranuar ankesë (Protokolli Nr. 34/23) nga OE "Muhamet Muçiqi BI NNP Ndërtimtari" sh.p.k për aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i infrastrukturës në Objektet e Universitetit" me numër të prokurimit : "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, iniciuar nga iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Për aktivitetin prokurimit në rastin konkret, AK me 28.12.2022 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e autoriteti kontraktues, sipas të cilit aktiviteti i prokurimit është anuluar në tërësi.

Me 02.01.2023, OE ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim të vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është refuzuar si të pa pabazuar me Vendimin e AK të datë 05.01.2023.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 20 janar 2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të aprovet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i atakuar i AK dhe lënda të kthehet në rivlerësim;

Duke vepruar mbi bazën e parimeve përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

- Lidhur me këtë të aktivitet të prokurimit AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar 135.000 €;

- Kurse, pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, konsistojnë në faktin se AK e ka eliminuar Ankuesin me arsyetimin se gjatë vlerësimit kanë hasur në disa pozicione të pa definuara mirë që të njëjtat mundën të ndikojnë në ekzekutimin dhe kualitetin e punimeve;

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të aktivitetit të prokurimit, analizimit të tyre, pretendimeve reciproke të palëve, përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues, konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues i klasifikon si të bazuara dhe se lidhur me arsyen e dhënë të eliminimit PSH konstaton se AK nuk ka paraqitur bazë ligjore, fakte apo argumente të mjaftueshme me të cilën konstatohet se është aplikuar neni 62 i LPP-së, andaj PSH në këtë rast ka gjetur mbështetje në raportin e ekspertizës, kështu që arsyetimet e tij llogariten si arsyetime të PSH.

Ankuesi, nga cilësia e tij si OE është eliminuar nga AK, nga ky aktivitet i prokurimit për arsyen si në vijim, cituar (në origjinale)

“Gjate vlerësimit kemi hasur në disa pozicione të pa definuara mirë që të njëjtat mundën me ndikojnë në ekzekutimin dhe kualitetin e punimeve:

- a) Në pozicionin 3tc të paramasë specifikohet që shtylla të ketë dimensione të prerjes tërthore 80 x 60 x 2.5 mm ndërsa në përshkrim teknik (detalin e skicuar) është kërkuar 8 x 80 x 3mm. B
- b) Në pozicionin 3tc të paramasë specifikohet që themeli nga betoni të ketë dimensione 60 x 60x 60 cm ndërsa në përshkrim teknik (detalin c skicuar) është kërkuar me dimensione 60 x 50 cm
- c) Në pozicionin 3te të paramasë specifikohet që shufrat vertikale të kenë dimensione 20x 20x2.0 mm ndërsa në përshkrim teknik (detalin e skicuar) është 16x20x20x2mm. Me qëllim që të mos kemi probleme gjatë ekzekutimit dhe mos të vij deri të rritja e buxhetit gjatë ekzekutimit, rekomandojmë: 1. Tenderi të anulohet, 2. Të përgatiten specifikat e tenderit me të gjitha karakteristikat teknike për ekzekutim,(eliminon mangësitë)

Andaj duke u bazuar në raportin e ekspertit, dispozitat përkatëse si dhe arsyetimin për ndryshimin e specifikave teknike në këtë fazë, Paneli e klasifikon si të papranueshëm, që si veprim me anë të aktit të nxjerrë nuk klasifikohet dhe nuk aplikohet tek arsyet dhe shkaqet që lejojnë anulimin e një procedure të prokurimit, konkretisht dispozitat ligjore siç janë, neni 62 i LPP-së si dhe dispozitat përkatëse të RROUPP, të dy këto legjislatore përcaktojnë shkaqet apo arsyet si dhe situatën kur lejohet anulimi i procedurës së prokurimit, andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka vepruar

në kundërshtim këto dispozita, përveç tjerash OE ankues ka ofruar të dhëna të natyrës teknike që arsyetojnë ankesën e tij në aspektin përmbajtësor, ndërsa në anën tjetër këto të njëjtat AK nuk i ka kundërshtuar me bazë ligjore teknike e poashtu OE ankues ka ofertuar në këtë aktivitet bazuar në paramasën e paraqitur nga AK, andaj bazuar mbi të gjitha këto, PSH konstaton se AK nuk ka ofruar bazë arsyetuese të mjaftueshme për të vërtetuar se ky aktivitet duhet të anulohet në tërësi.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë
- 1x1 GOE Nil Architects Sh.P.K. Hidro Project Sh.P.K., me seli në-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.